



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.277, datë 24.10.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Kujtim Basha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Zoti Kujtim Basha, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nga data 01.11.2022-31.01.2023.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kujtim Basha, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm zoti Kujtim Basha do të përfitojë pagën e prokurorit të apelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 24.10.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani